

JOLANDA BIBAJ

FUNKSIONI PREDIKATIV I MBIEMRIT NË FJALI

Predikativiteti është ndër tiparet gramatikore më të përgjithshme që u përket të gjitha llojeve të fjalive. Fjalitë predikative njihet ndryshe edhe si fjali e varur kallëzuesore, e cila kryen në periudhë po atë funksion që kryen në fjali kallëzuesi emëror apo plotësori kallëzuesor¹. Në përgjithësi lidhja predikative është parë si lidhje mes kryefjalës dhe një gjymtyrë mbiemërore që lidhet me të përmes foljes këpujë *jam*. Ky mbiemër tregon një cilësi të kryefjalës, i pohon asaj një tipar të përcaktuar qartë. Mirëpo mbiemri në këtë funksion nuk lidhet vetëm përmes foljes *jam*. Ka edhe një grup tjetër foljesh nga të cilat mbiemri kryen funksion predikativ, siç janë foljet: *dukem, ndjej, shoh, dëgjoj, gjykoj, përfytyroj, quaj, kujtoj*, etj. Më poshtë do të shohim raste specifike të përdorimit të mbiemrit në funksion predikativ pas këtyre foljeve. Ndërkaq, kur krahasojmë shqipen me gjuhë të ndryshme, vërejmë se disa gjuhë i vendosin mbiemrat para emrit, e disa të tjera pas tij. Kjo vendosje është e kuptueshme nëse mbahet parasysh fakti që mbiemrat lidhen funksionalisht vetëm me emrin, para ose pas tij. Pikërisht mbiemrat quhen të tillë në gjuhë si anglishtja, frëngjishtja, italishtja apo ndonjë tjetër, sepse shoqërojnë emrin në pozicione pranë tij, kurse kur e zëvendësojnë atë, quhen përemra. Megjithatë nuk ka një pozicion të prerë. Për arsye emfaze, mbiemrat që në gjuhë të caktuara janë të pozicionuar pas emrave, kalojnë përpara tyre, gjithashtu në gjuhë që pozicionohen para emrave dhe për arsye stilistike kalojnë pas emrit. Në anglishte p.sh., mbiemrat që pozicionohen para emrave marrin funksion atributiv, kurse ata që vendosen pas emrave marrin funksion predikativ, madje ka edhe mbiemra që pozicionohen pas emrit të modifikuar, për t'i shtuar një karakteristikë më tepër. Megjithatë edhe mbiemrat në funksion predikativ, nuk vijnë menjëherë pas emrit, por pas një foljeje dhe modifikojnë emrin që paraprind foljen.

Në ligjërimin e shkruar është e lehtë të gjenden sintagma të tilla si: *qeveria franceze dhe gjermane, populli shqiptar dhe amerikan* etj., që në

¹ S. Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Enti botues i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë, 1971, f. 266.

fakt nuk janë në përputhje me normën kur duhet: *qeveria franceze dhe ajo gjermane, populli shqiptar dhe ai amerikan*. Megjithatë ky përdorim mund të merret si i pranueshëm, po të kihet parasysh ekonomia gjuhësore. Lexuesit, teksa lexon gazetën apo dëgjon emisionin e lajmeve, nuk i shkon mendja për një qeveri të përzier franceze dhe gjermane, por për dy të ndryshme. Përdorimi i dy mbiemrave të tillë është i pranueshëm, duke qenë se shqiptimi i tyre pas lidhëzës *dhe* bëhet me një pauze të shkurtër. Po kështu, në ligjërimin gazetaresk ndeshen dendur disa sintagma me përdorime eliptike. Të tillë shembuj dalin të shkruar: *konflikt për arsye pronësore* (që ndodh për arsye të pronave, të shkaktuar nga kthimi / moskthimi / tjetërsimi i pronave), *institucion shtetëror me interesa private* (i krijuar / i tjetërsuar për interesa që janë dukshëm private). Edhe në sintagma të tilla mbiemri merr funksion predikativ.

Për SMb funksioni predikativ është tipik. Por përveç sintagmave mbiemërore edhe plotësorët mund të kryejnë një funksion predikativ.

(1) *Ajo ishte e lodhur me sjelljen e tij të pakorrigjueshme.* (plotësor predikativ)

(2) *E lodhur me sjelljen e tij të pakorrigjueshme, ajo u largua përfundimisht prej tij.* (periferik predikativ)²

Termi “plotësor”, në gramatika të ndryshme përdoret vetëm në lidhje me shprehje emërore dhe mbiemërore, të cilat bashkohen me këpujën në fjali, si:

(3) *Laura është një vajzë e bukur.*

(4) *Laura është e bukur.*

Nëse marrim në analizë fjalinë:

(5) *E përfytyrova Anën të lodhur.*

(6) *E përfytyrova Anën të lexonte e lodhur.*

Do të shohim që mbiemri *të lodhur* kryen një funksion predikativ ndaj pjesës tjetër të fjalisë. Sipas gjuhëtares L. Buxheli, ky mbiemër (*të lodhur*) bën pjesë në fjalitë pa folje, ose ndryshe fjalitë e vogla. Këto fjali kanë një strukturë të tillë:

A. E përfytyrova [Anën të lodhur]

B. E përfytyrova [Anën të lexonte [e lodhur]]
[kallëzore] [emërore]

² A. Kananaj, *Çështje të rrethanorit në gjuhën shqipe*, SF, 2008/1-2, f. 133.

Sipas saj këto njësi predikative minimale, ndryshe, fjali të vogla, megjithëse nuk kanë kryefjalë të shprehur me një SE në rasën emërore, sepse pozicioni [Spec, SEPT] i fjalisë së vogël në të dy rastet ka tiparin [-Rasë], nuk mund të thuhet se s'kanë kryefjalë. Fjalja A (*E përfytyrova Anën të lodhur.*), e ka të realizuar fonetikisht kryefjalën në pozicionin [Spec, SEPT]. SE *Anën* është kryefjalë e fjalisë së vogël me predikatin mbiemëror të *lodhur*. Ky predikat përshtatet në rasën kallëzore me kryefjalën *Anën*, që merr rasë përjashtimore nga folja *përfytyrova* e fjalisë drejtuese sepse ndodhet në pozicionin [-Rasë].³

Fjalja e vogël në B nuk mund të ketë kryefjalë të realizuar fonetikisht. (Kryefjala quhet e përealizuar fonetikisht atëherë kur nuk shprehet, nuk duket, d.m.th. që nuk është shprehur në pozicionin e saj sintaksor në strukturën sipërfaqësore, por nënkuptohet, mund të futet lehtë në fjali). SE *Anën* nuk është kryefjalë e fjalisë së vogël me predikat mbiemëror, por e fjalisë me predikat foljor *Anën të lexonte*. Kjo kryefjalë, sipas Buxhelit, kontrollon një kryefjalë zero të predikatit *e lodhur*. Në këtë rast kemi të bëjmë me një kryefjalë të përealizuar fonetikisht që njihet ndryshe si kategoria PRO. Në këtë mënyrë shpjegohet edhe rasa emërore e mbiemrit të *lodhur*.

Në sintagmën emërore shohim edhe disa sintagma me kuptim të figurshëm, në të cilat fjala që mbart kuptimin e figurshëm shërben si karakterizues, cilësues, kufizues i asaj që shpreh gjymtyra tjetër. P.sh.: *Bindje e thellë* (ku sintagma *e thellë* karakterizon SE *bindje*, dhe folja këpujë *jam* është e nënkuptuar). Përveç këtyre kemi edhe disa lloje të tjera sintagmash ku gjymtyra krahasuese shërben për të sqaruar kuptimin e fjalës tjetër, duke e krahasuar me një objekt tjetër që ka një tipar të dallueshëm e të përhershëm, p.sh.: *i zi si qymyri*, *i zi si korbi*, i bardhë **si bora**, i ëmbël **si mjalti**. Por ka edhe raste të tjera të përdorimit të sintagmave mbiemërore me kuptim të figurshëm, ironik, si në SMb *i drejtë si drapri* (nënkuptojmë një njeri hileqar, dinak, gënjeshtar, të padrejtë etj). Po të vështrojmë një shembull tjetër:

(7) *Ai është mirë!*

Në të vërtetë *mirë* është ndajfolje, por folja *jam* për vetë semantikën e saj nuk duhej të merrte përcaktues ndajfoljorë, cilësorë e mënyrorë, por vetëm mbiemërorë, si dhe arsyeja tjetër që përforcon këtë ide, ka të bëjë me faktin se ndajfolja dallon nga mbiemri vetëm nga nyja, krahasojmë: *Ai*

³ L. Buxheli, *Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe*, Neraida, Tiranë, 2007, f. 92.

është mire! / *Ai është i mire!*, ku në të parin tregohet një gjendje e subjektit përmes ndërmjetësimit të kallëzuesit, kurse në të dytin një cilësi e subjektit që ndërmjetësohet nga kallëzuesi. Nga kjo mund të kuptohet pse anglishtja p.sh. i ka shkrirë në një kategori të vetme këto dy klasa. Në përgjithësi, mbiemrat kur janë në funksion predikativ, shfaqin një lidhje të ngushtë me foljen. Kur kallëzuesi është perifrastik, në të gjitha rastet, ai shprehet me ndihmën e foljes këpujë *me qenë* (jam) dhe zakonisht një mbiemër, por edhe një emër, përemër, numëror, ndajfolje si dhe një fjali e tërë.⁴

Mbiemrat hyjnë në dy lidhje sintaksore:

✚ Të predikativit përcaktues të emrit që shpreh sendin.

✚ Predikativit përcaktues të foljes që shpreh veprimin.⁵

Kemi marrë në shqyrtim një shembull nga Camaj për të ilustruar funksionin predikativ.

(8) a. ...*gjarpën i stilizuem* (e cila mund të interpretohet si: është gjarpër i stilizuar, ngjan si gjarpër i stilizuar) (M. Camaj, Palimpsest, Camaj-Pipa, 2005, f. 20.)

b. *në lëvizje të rrezes duket e zhduket / hije e nxjerrun në kujtesë e i thyem me tri pjesë* (Camaj, po aty, f. 20.)

Ajo që na intereson në këta dy shembuj, është interpretimi sintaksor i cili ka të bëjë me marrëdhënien e predikativitetit; mbiemrat: *i stilizuem*, mbiemri prejfoljor *e nxjerrë*, mbiemri *i thyer*, marrin vlerë predikativiteti vetëm nëse ndjekin emrin. Marrëdhënia e predikativitetit, si një lloj i veçantë marrëdhënieje ndërvaresie mund të realizohet në mënyra të ndryshme, si p.sh.: me një folje të shtjelluar – *duket / zhduket, është, ngjan, mbetet*, por jo domosdoshmërisht.⁶ Lidhja predikative, sipas T. Topallit përbëhet nga subjekti dhe një entitet i njohur dhe që gramatikisht shprehet me një emër në rolin e kryefjalës dhe nga predikati.⁷ Kryefjala këtu është e shprehur tek vargu i parë me sintagmën- *Shkronja nistore* e cila rimerret në mënyrë anaforike me sintagmat: *gjarpën i stilizuem, hije që duket e zhduket, hije e nxjerrun, krijesë absurde*.

⁴ S. Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Enti i teksteve dhe mjeteve mësimore të Krahinës Socialiste Autonome e Kosovës, Prishtinë, 1971, f. 63.

⁵ A. Dhimo, *Mbi disa çështje të klasifikimit morfologjik të mbiemrave në shqipen e sotme*, SF, 1969/1, f. 64.

⁶ G. Graffi, *Sintaksa, Strukturat e ligjëritimit*, Dituria, Tiranë, 2003, f. 128.

⁷ T. Topalli, *Gramatikë e gjuhës shqipe, sintaksa e fjalisë*, sprovë monografike, Shkodër, 2011, f. 390.

Megjithëse gjuha shqipe nuk ka një shkallë mohore për mbiemrin, ka raste kur mbiemri në funksion predikativ, cilësia e treguar prej tij, i mohohet emrit të përcaktuar prej tij. Këtë mund ta vërejmë në shembujt:

(9) *Klasa nuk ishte e pastruar.*

(10) *Ata vërtetë nuk ishin të bindur kundrejt mësuesit.*

Në këtë rast gjuha, për tregimin e cilësisë që në fakt nuk zotërohet nga sendi, përdor po atë formë mbiemri, pra e pohon njëherë praninë e cilësisë tek sendi dhe me një mjet tjetër gjuhësor (pjesëzat e mohimit), kthehet dhe e mohon jo cilësinë, por praninë e saj tek sendi përkatës.⁸ Le të shohim disa shembuj të tjerë:

(11) *“Votra ishte burim andrrimesh”* (M. Camaj, “Vepra letrare 1”, Apollonia, 1996, f.105) krahaso p.sh.: *Votra nuk ishte burim andrrimesh.*

(12) *E gjeta nënën të mërzhitur!* – *e gjeta nënën të pamërzhitur.

(13) *E gjykoi si të drejtë.* – *e gjykoi si të padrejtë.

(14) *E quajta të arsyeshme të mos vij më.* – *e quajta të paarsyeshme të mos vij më/ e quajta të paarsyeshme të vij më.

(15) *E kujtonte e përmalluar atë vështrimin e kaluar.* – e kujtonte e papërmalluar atë vështrimin e kaluar.

Këtu shfaqet përsëri funksioni predikativ i mbiemrit. Studiuesi A. Dhrimo pohon se mbiemri substantivohet gramatikisht kur ndodhet në funksion predikativ, në shkallën pohore. Në këto raste forma pohore ka vlerën kuptimore të shkallës krahasore të sipërisë absolute.⁹

Gjithashtu edhe përcjellorja, kur përdoret si pjesë e kallëzuesit perifrastik, merr ngjyra dhe nuancë mbiemërore¹⁰ si në shembullin:

(16) *Ai është duke vdekur, duke dhënë shpirt.*

Mbiemri shfaqet në funksion predikativ edhe atëherë kur mund të zëvendësohet nga një fjali e varur atributive, si p.sh.:

(17) *Njeriu gënjeshtar, të lë në baltë!*, (e cila mund të zëvendësohet nga: Njeriu që gënjen, të lë në baltë! Njeriu që është gënjeshtar, të lë në baltë!)

(18) *Një vapë e padurueshme* = një vapë që nuk durohet.

⁸ A. Dhrimo, *Rreth shkallëve të mbiemrit në shqipen e sotme letrare*, SF, 1969/2, f. 90.

⁹ A. Dhrimo, *Substantivimi i mbiemrave*, SF, 1971/1, f. 89.

¹⁰ S. Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Enti i teksteve dhe mjeteve mësimore të Krahinës Socialiste Autonome e Kosovës, Prishtinë, 1971, f. 64.

Mbiemri në funksion predikativ analizon kuptimin e kallëzuesit dhe varet prej tij, por pa shkëputur marrëdhëniet me kryefjalën, së cilës i specifikon kuptimin. Lidhja e mbiemrit me kallëzuesin këpujë *jam*, nuk realizohet vetëm me këtë folje, por edhe me folje me përdorime sinonimike me të, si p.sh.:

(19) *Beni është ëndërrimtar- Beni duket se ëndërron.*

(20) *Andi është guximtar- Andi duket se guxon.*

(21) *Nxënësit janë të kënaqur- Nxënësit duken të kënaqur.* (kjo e fundit mund të marrë plotësorë parafjalorë, si p.sh.: nga notat, me rezultatet, nga shpjegimi, nga ekskursioni, etj.)

(22) *E dëgjova të qante e trishtuar.* (për të cilën vlen analiza e mësipërme tek shembulli: *Anën të lexonte e lodhur.*)

Në strukturat e mundshme semantiko-sintaksore, në brendësi të të cilave realizohet sintagma mbiemërore, do të përmendim:

1. Folje + emër + mbiemër *e bën veshin të shurdhër, e ka gjuhën të gjatë, e ka qafën të shkurtër, e ka kokën të fortë, nuk shkel në dërrasë të kalbur, etj.*
2. Emër + mbiemër + emër *vrma e fundit e kavallit, zgjidhja më e përshtatshme e çështjes, etj.*
3. Mbiemër + emër + emër *i rrahur me vaj e me uthull, i rreptë me krimin e kriminelët, etj.*
4. Mbiemër + sintagmë parafjalore *i drejtë në vlerësim, i saktë në përgjigje, i shpejtë në veprim, etj.*
5. Emër + mbiemër *daulle e shpuar, fjalë e ëmbël, dorë e ngrohtë, gjuhë e gjatë, etj.*
6. Emër + emër me vlerë mbiemërore *i hurit e i litarit, i mirë për asgjë, etj.*

KONKLUZIONE

Nga sa u analizua më sipër, pamë që mbiemri merr funksion predikativ kur ndodhet pas emrit që përcakton dhe lidhet me të përmes foljes këpujë *jam*, por jo vetëm, ai lidhet edhe me folje të tjera të perceptimit shqisor ose ndijor si: *përfytyroj, ndjej, dëgjoj, gjej, shoh, gjykoj, quaj, konsideroj*, etj. Mbiemri kur përdoret para emrit merr funksion atributiv, kurse i përdorur pas tij, merr kryesisht funksion predikativ. Mbiemri në këtë funksion mund të zëvendësohet nga fjali atributive, si dhe shpesh bën pjesë në ato që quhen njësi minimale predikative ose fjali të vogla. Pavarësisht vendosjes së mbiemrit pas emrit, për të marrë funksion predikativ duhet që

ndërmjetësimi të bëhet përmes një foljeje konkrete ose të nënkuptuar. Ndër të tjera pamë edhe strukturat e mundshme të realizimit të sintagmave mbiemërore ku realizohet funksioni predikativ i tyre.

BIBLIOGRAFI

- Buxheli, L., *Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe*, Neraida, Tiranë, 2007.
- Dhrimo, A., *Mbi disa çështje të klasifikimit morfologjik të mbiemrave në shqipen e sotme*, SF, 1969/1.
- Dhrimo, A., *Rreth shkallëve të mbiemrit në shqipen e sotme letrare*, SF, 1969/2.
- Dhrimo, A., *Substantivimi i mbiemrave*, SF, 1971/1.
- Graffi, G., *Sintaksa, Strukturat e ligjërit*, Dituria, Tiranë, 2003.
- Kananaj, A., *Çështje të rrethanorit në gjuhën shqipe*, SF, 2008/1-2.
- Prifti, S., *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Enti i teksteve dhe mjeteve mësimore të Krahinës Socialiste Autonome e Kosovës, Prishtinë, 1971.
- Topalli, T., *Gramatikë e gjuhës shqipe, sintaksa e fjalisë*, sprovë monografike, Shkodër, 2011.

LITERATURË E VJELË

- Camaj, M., *Vepra letrare 1*, Apolonia, 1996.
- Camaj, M., *Palimpsest*, Camaj-Pipa, 2005.

